

**Asociacioni/Bashkësia
e komunave me shumicë serbe në Kosovë
Draft STATUT**

www.gazetaexpress.com

Në përputhje me Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve për Rregullimin e Normalizimit të Marrëdhënieve,

në pajtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Ligjin për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,

me qëllim të avancimit të demokracisë dhe qeverisjes lokale dhe duke i respektuar dispozitat e mbrojtjes dhe përfaqësimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve, të rrënjosura në Kushtetutën dhe në ligjet e Kosovës,

duke e demonstruar gatishmërinë për ta zbatuar Marrëveshjen për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, në mirëbesim dhe pa asnjë parakusht,

Qeveria e Republikës së Kosovës e miraton Statutin e Asociacionit të Komunave, në të cilat Komuniteti Serb është shumicë.

I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 [definicionet]

1. Termat dhe shprehjet e poshtëshënuara, të përdorura në këtë Statut, do ta kenë kuptimin e mëposhtëm:

- a. Asociacion - Asociacioni i Komunave në të cilat Komuniteti Serb është në shumicë.
- b. Autoritete qendrore - Presidenti, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës.
- c. Ligjet e Zbatueshme - ligjet dhe legjislacioni tjetër i Republikës së Kosovës.
- d. Gazetë Zyrtare - Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Neni 2 [qëllimi]

1. Komuniteti serb i Kosovës është komunitet tradicional etnik me tipare të dallueshme gjuhësore, kulturore e fetare, që ka banuar në Kosovë me shekuj krahas komuniteteve të tjera tradicionale. Me anë të Nenit 57 të Kushtetutës, si komunitet tradicional, komuniteti serb ka të drejta specifike shtuar të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të ofruara në Kapitullin II të Kushtetutës.

2. Qëllimi parësor i këtij Statuti është që të krijojë mundësi të reja për komunitetin serb të Kosovës për të përfituar nga këto të drejta specifike tashmë të rrënjosura në Kushtetutë dhe në Ligjet e zbatueshme.

3. Asociacioni, i themeluar me anë të këtij Statuti, synon që të ofrojë një kornizë të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, mundësinë për ofrimin e shërbimeve në fusha specifike, përfshirë mundësinë për mbështetje financiare nga Serbia, dhe një kanal të drejtpërdrejtë efikas të komunikimit për komunitetin serb me Qeverinë e Kosovës.

Neni 3 [Statuti]

1. Ky Statut është akti më i lartë ligjor që i rregullon pozitën, kompetencat, fushëveprimin e punës, organizimin dhe funksionimin e trupave, dhe të gjitha punët e tjera të Asociacionit.
2. Asociacioni konsiderohet i themeluar me publikimin e këtij Statuti në Gazetën Zyrtare pas një shqyrtimi pozitiv nga Gjykata Kushtetuese.
3. Ky Statut hyn në fuqi me miratimin nga Kuvendi i Asociacionit në seancën konstituuese.

Neni 4 [amendamentet]

1. Vetëm trupat e Asociacionit të themeluar, dhe komunat anëtare të tij, e kanë të drejtën për të propozuar amendamente për këtë Statut. Përmes Zyrës së Kryeministrit, Presidenti i Asociacionit i paraqet amendamentet e propozuara në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim.
2. Pas një shqyrtimi pozitiv nga Gjykata Kushtetuese, Qeveria i miraton amendamentet.
3. Me publikimin në Gazetën Zyrtare, amendamentet hyjnë në fuqi me miratimin nga Kuvendi i Asociacionit.

Neni 5 [procedurat e themelimit]

1. Jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendrike pas publikimit në Gazetë Zyrtare, komunat që dëshirojnë të bëhen anëtare themeluese të Asociacionit do ta informojnë (me shkrim) Zyrën e Kryeministrit për qëllimin e tyre. Letra e qëllimit duhet të miratohet nga Kuvendi Komunal.
2. Pragu është një minimum prej tri (3) komunash të interesuara për t'u bërë anëtare themeluese të Asociacionit.
3. Një komunë pjesëmarrëse gjithashtu duhet ta ofrojë listën e delegatëve që e përfaqësojnë komunën në seancën konstituuese të Kuvendit të Asociacionit.
4. Kuvendi i Asociacionit përbëhet nga përfaqësues të emëruar nga secila komunë pjesëmarrëse. Anëtarët e Kuvendit të Asociacionit zgjidhen nga Kuvendet Komunale të

komunave pjesëmarrëse. Me shumicë votash, secili Kuvend Komunal zgjedh pesë përfaqësues për të shërbyer si anëtarë të Kuvendit të Asociacionit. Këta përfaqësues zgjidhen në mesin e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit Komunal, duke qenë të ndërgjegjshëm për përbërjen politike dhe etnike.

5. Mandati i Kuvendit të Asociacionit do të jetë i lidhur me mandatet e kuvendeve komunale të komunave pjesëmarrëse. Pas çdo zgjedhjeve lokale, brenda një muaji pas themelimit të kuvendeve komunale, kuvendet komunale të themeluara në këtë mënyrë do t'i nënshtrohen procedurës së zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Asociacionit, me anë të procedurës së njëjtë të përvijuar në pikën 4.

6. Jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas publikimit të këtij Statuti në Gazetën Zyrtare, Kryeministri i publikon listën e komunave anëtare themeluese të Asociacionit dhe listën e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Asociacionit.

7. Seanca konstituuese duhet të mbahet jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë kalendarike pas publikimit të këtij Statuti në Gazetën Zyrtare.

8. Axhenda e seancës konstituuese duhet t'i përfshijë pikat e mëposhtme:

- a. Konfirmimin e listës së pjesëmarrësve.
- b. Miratimin e Statutit.
- c. Zgjedhjen e Kryetarit.

Dinamikat e tjera, të lidhura me seancën konstituuese, vendosen mes anëtarëve themelues.

Neni 6 [kapaciteti ligjor dhe karakteri i dallueshëm]

1. Asociacioni i ka të drejtat e mëposhtme:

- a. Të paditë dhe të paditet,
- b. Të ketë në pronësi pronë të luajtshme dhe të paluajtshme,
- c. Të ketë në bashkëpronësi entitete që ofrojnë shërbime lokale brenda fushëveprimit të Asociacionit,
- d. Të bëjë kontrata, përfshirë kontratat e punësimit,
- e. Dhe të drejta të tjera të specifikuar në këtë Statut.

2. Asociacioni është një Entitet i Posaçëm Ligjor i së Drejtës Publike, i themeluar me anë të Lex Specialis, "Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që e Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve".

3. Për nevojat e këtij Statuti, një "Entitet i Posaçëm Ligjor i së Drejtës Publike" nënkupton një organizatë unike, e themeluar me anë të një ligji të posaçëm përkatës, që është e aftë për të kryer detyra specifike jofitimprurëse jopublike dhe detyra publike siç autorizohet me anë të ligjit të posaçëm.

4. Për nevojat e këtij Statuti, "detyrat publike specifike" e nënkuptojnë aftësinë e Asociacionit për të vepruar si një trup i përbashkët administrativ për të kryer detyra specifike të rregulluara me anë të autorizimeve të posaçme të përvijuara në këtë Statut.

5. Me anë të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, mundësimi i atribuimit të kompetencave dhe përgjegjësiive për qëllime specifike në përputhje me ligjin, dhe, me anë të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, mundësimin që Qeveria ta delegojë kryerjen e detyrave specifike të përcaktuara qartë nga legjislacioni i posaçëm me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve publike, gjatë kryerjes së detyrave publike specifike, Asociacioni do të veprojë në kapacitetin e një Agjencie të Specializuar nën kompetencat e Kryeministrit.

Neni 7 [parimet kryesore]

1. Asociacioni e kryen aktivitetin e vet duke u bazuar në Kushtetutën dhe në ligjet e zbatueshme.

2. Trupat e Asociacionit do t'i respektojnë plotësisht të dyja gjuhët zyrtare, serbishten dhe shqipen.

3. Me qëllim të arritjes së objektivave të veta, Asociacioni do të jetë i liruar nga detyrimet dhe taksat mbi bazën e njëjtë si komunat pjesëmarrëse.

Neni 8 [emri zyrtar]

1. Emri zyrtar i Asociacionit është "Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe".

2. Shkurtesa zyrtare është CSMM.

3. Emri zyrtar i Asociacionit është pa paragjykim ndaj komuniteteve të tjera etnike që banojnë në këto komuna, dhe nuk nënkupton asnjë parim përjashtimi.

Neni 9 [të drejtat e komuniteteve]

1. Asociacioni i themeluar nuk do t'i zëvendësojë, nuk do t'ua zërë vendin ose nuk do t'i pakësojë të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve që banojnë në këto komuna.
2. I tërë ndërveprimi zyrtar me Asociacionin bëhet në njëren (ose të dyja) gjuhët zyrtare të Kosovës, serbisht dhe shqip. Gjatë ndërveprimit (edhe me gojë, edhe me shkrim) me Asociacionin, anëtarët e komuniteteve të tjera (jo-serbe dhe jo-shqiptare) janë të lirë për t'iu drejtuar Asociacionit në gjuhën e tyre të nënës. Asociacioni do t'i ofrojë shërbimet e nevojshme të përkthimit.
3. Përfaqësuesit e zgjedhur komunalë nga komunitetet e tjera (jo-serbe) do të gëzojnë përfaqësim proporcional në trupat e Asociacionit.
4. Çdoherë, do të jetë një Nënkryetar i Kuvendit të Asociacionit dhe një Nënkryetar i Bordit, që i përfaqësojnë komunitetet e tjera (jo-serbe). Vetëm zyrtarët e zgjedhur komunalë nga komunitete të tjera (jo-serbe) janë të pranueshëm për këto pozita.
5. Anëtarët e komuniteteve të tjera do të gëzojnë përfaqësim proporcional në të gjitha pozitat e tjera të punës.

Neni 10 [simbolet zyrtare]

1. Asociacioni do t'i ketë simbolet e veta zyrtare, përfshirë një stemë dhe një flamur në përputhje me ligjet e zbatueshme.
2. Dizajni i këtyre simboleve duhet t'i pasqyrojë parimet e gjithëpërfshirjes dhe respektin për të gjitha komunitetet etnike, fetare e të tjera.
3. Një Komisioni i Posaçëm do ta propozojë dizajnin e këtyre simboleve. Anëtarë të këtij Komisioni janë tre përfaqësues të Asociacionit, një që i përfaqëson komunitetet e tjera (jo-serbe), një përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit dhe një përfaqësues i Bashkimit Evropian.
4. Komisioni duhet ta përfundojë punën e vet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pune pas seancës konstituuese.
5. Kuvendi i Asociacionit i miraton simbolet zyrtare pas pranimin të propozimit të Komisionit.

Neni 11 [anëtarësia]

1. Anëtarësia është e mbështetur në parimet e pjesëmarrjes vullnetare.

2. Pjesëmarrja vullnetare i nënkupton aftësinë për të vendosur në mënyrë të lirshme për t'iu bashkuar Asociacionit, lirinë për ta ndërprerë anëtarësinë, dhe lirinë për ta përjashtuar veten nga çfarëdo ushtrimi i përbashkët që kryhet nga Asociacioni.
3. Anëtarësia nuk nënkupton që Asociacioni do t'i zëvendësojë ose pakësojë të drejtat dhe kompetencat e komunave pjesëmarrëse.
4. Komunitat anëtare janë të lira për t'iu bashkuar asociacioneve të tjera në përputhje me ligjet e zbatueshme.
5. Asociacioni i themeluar është i hapur për anëtarësi për çfarëdo komune tjetër. Aplikimi për anëtarësim shqyrtohet ndarazi në Kuvendet Komunale të të gjitha komunave anëtare. Aplikimi është i pranuar, nëse pajtohen dy të tretat e të gjithë anëtarëve.
6. Një komunë anëtare mund të përjashtohet përmes një vendimi të mbështetur nga shumica prej dy të tretave e të gjithë anëtarëve të vet, me anë të procedurës së njëjtë të përvijuar në pikën 5.
7. Asociacioni mund të shpërbëhet vetëm përmes një vendimi të mbështetur nga shumica prej dy të tretave të të gjithë anëtarëve të vet, me anë të procedurës së njëjtë të përvijuar në pikën 5.
8. Në rast të një vendimi për shpërbërje, Zyra e Kryeministrit e kryen procesin e shpërbërjes.

Neni 12 [asetet e Asociacionit]

1. Asetet e caktuara për, ose që janë në pronësi të Asociacionit, janë pronë publike.
2. Komunitat pjesëmarrëse nuk mund t'ia kalojnë Asociacionit pronësinë e pronës së tyre të paluajtshme.
3. Në rast të shpërbërjes, asetet e Asociacionit të shpërbërë ndahen në mënyrë të barabartë mes ish-anëtarëve të tij.

Neni 13 [selia e Asociacionit]

1. Kuvendi i Asociacionit vendos për Selinë e Asociacionit në seancën e parë të punës pas seancës konstituuese.
2. Komuna pritëse do t'i ofrojë të gjitha objektet e nevojshme për funksionimin e Asociacionit.
3. Asociacioni mund të marrë me qira ose të blejë hapësirë shtesë të punës.

Neni 14 [marrëdhëniet me Republikën e Serbisë]

1. Me anë të dispozitave të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Nenit 59 të Kushtetutës, kjo kornizë e vetëmenaxhimit e pranon dhe e mbështet të drejtën e komunitetit serb për të mbajtur kontakte e lidhje me Republikën e Serbisë dhe me popullin e saj.
2. Asociacioni do të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe do ta luajë pjesën e vet në normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Asociacioni e bën këtë përmes promovimit të integritit institucional e shoqëror të komuniteteve jo-shumicë, pajtimit, bashkëpunimit dhe ndërtimit të besimit mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë, dhe përmes promovimit të nevojës për bashkëpunim e normalizim të plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, për të mirën e të gjithë njerëzve dhe të të gjitha komuniteteve.
3. Asociacioni ka të drejtë që të pranojë asistencë të drejtpërdrejtë nga Republika e Serbisë. Kjo asistencë mund të jetë financiare, mallra dhe pajisje, dhe ekspertizë profesionale.
4. Donacionet e mallrave dhe pajisjeve do të lirohen nga çfarëdo takse ose detyrimi.
5. Deri në normalizimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, Asociacioni është i autorizuar që t'i menaxhojë institucionet e arsimit dhe të kujdesit shëndetësor të themeluara dhe të financuara nga Republika e Serbisë, me anë të procedurës dhe hapave specifikë të përvijuar në këtë Statut.

Neni 15 [Bashkëpunimi Ndërkombëtar]

1. Asociacioni mund të bëjë Memorandume/Marrëveshje me Asociacione Komunale dhe organizata joqeveritare me bazë jashtë Kosovës.
2. Asociacioni mund të bëjë Memorandume/Marrëveshje me institucione të shteteve të tjera dhe organizata ndërkombëtare vetëm nëse marrëveshjet e tilla nuk përmbajnë obligime ligjërish të detyrueshme për Qeverinë e Kosovës. Për t'i bërë këto marrëveshje, Asociacioni duhet t'i përmbahet plotësisht Nenit 12 të Ligjit për Marrëveshje Ndërkombëtare.
3. Asociacioni mund të shprehë interesim për bërje të Memorandumeve/Marrëveshjeve ligjërish të detyrueshme me agjenci të huaja qeveritare, organizata ndërqeveritare ndërkombëtare, dhe agjenci të specializuara. Me anë të neneve 4 dhe 6 të Ligjit për Marrëveshje Ndërkombëtare, këto Memorandume/Marrëveshje mund të bëhen vetëm nga Kryeministri i Kosovës. Asociacioni do t'i ofrojë Kryeministrit një arsyetim të hollësishëm për përfitimet nga një marrëveshje e tillë. Në mirëbesim, Zyra e Kryeministrit do t'i japë Asociacionit një mundësi të vërtetë për t'u dëgjuar dhe për ta diskutuar në mënyrë gjithëpërfshirëse arsyetimin prapa nismës së tyre. Kryeministri/ja e merr vendimin e tij/saj

përfundimtar i/e drejtuar nga interesi i përgjithshëm publik dhe interesat strategjike të Kosovës.

II - KOMPETENCAT, AUTORIZIMET DHE DETYRAT

Neni 16 [kompetencat bërthamë]

1. Me anë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Asociacioni do të veprojë si forum për bashkëpunim dhe bashkërendim ndërkomunal përmes së cilit komunat anëtare shqyrtojnë çështje të interesave të tyre të përbashkëta, promovojnë, shpërndajnë, dhe mbrojnë çështje të interesit të përbashkët, e vlerësojnë ofrimin e shërbimeve publike tek anëtarët e tij dhe banorët e tyre, dhe ofrojnë shërbime për anëtarët e tij me anë të ligjeve të zbatueshme.
2. Asociacioni do të angazhohet në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komunitetit serb të Kosovës në vijë me Kapitullin III të Kushtetutës. Ky angazhim nuk do t'i zëvendësojë, përjashtojë, zërë vendin ose pakësojë të drejtat dhe interesat e entiteteve të tjera ligjore që e përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës për t'i ndjekur qëllimet e njëjta.
3. Asociacioni do ta promovojë dhe do ta mbështetë kthimin e të gjithë personave të zhvendosur.
4. Asociacioni do të bashkërendojë, do të lehtësojë dhe do të kryejë aktivitete hulumtuese e zhvillimore.
5. Për ta lehtësuar ushtrimin e këtyre kompetencave, trupat e Asociacionit e kanë të drejtën për t'i miratuar të mëposhtmet:
 - a. Rregullore, akte ligjore që rregullojnë, në mënyrë të përgjithshme, çështje që janë nën kompetencat bërthamë të përvijuara në Nenin 16 të Asociacionit.
 - b. Vendime.
 - c. Deklarata.
 - d. Rregulla të Procedurës.
 - e. Instruksione.
6. Gjatë ushtrimit të kompetencave të përvijuara në këtë Nen, Asociacioni gëzon pavarësi të plotë funksionale, i lirë nga çfarëdo kompetence nga cilido autoritet qendror.

Neni 17 [detyrat e deleguara - autorizimet e posaçme]

1. Me anë të Nenit 6 të këtij Statuti, për t'i kryer detyrat e saktësuara më poshtë, Asociacioni do të veprojë si një Agjenci e Specializuar nën kompetencat e Zyrës së Kryeministrit. Në kapacitetin e një Agjencie të Specializuar, Asociacioni do të kryejë funksione bashkërenduese dhe funksione të natyrës horizontale në fushat e saktësuara në pikën katër (4) të Marrëveshjes së Parë për Parimet që e Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike dhe kryerjen e detyrave administrative, sipas nevojave specifike të komuniteteve lokale.
2. Asociacioni do të ushtrojë pasqyrë të përgjithshme (rregullon, organizon, bashkërendon dhe kryen punë) për ta zhvilluar ekonominë lokale të komunave anëtare të tij.
3. Asociacioni do të ushtrojë pasqyrë të përgjithshme (rregullon, organizon, bashkërendon dhe kryen punë) në fushën e arsimit në territorin e komunave anëtare të tij.
4. Asociacioni do të ushtrojë pasqyrë të përgjithshme (rregullon, organizon, bashkërendon dhe kryen punë) për ta përmirësuar kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor në territorin e komunave anëtare të tij.
5. Asociacioni do të ushtrojë pasqyrë të përgjithshme për ta bashkërenduar planifikimin urban e rural në territorin e komunave anëtare të tij.
6. Asociacioni është i autorizuar për t'i menaxhuar plotësisht institucionet e arsimit dhe të kujdesit shëndetësor të themeluara dhe të financuara nga Republika e Serbisë me anë të procedurave specifike të përvijuara në Nenet 14 dhe 19 të këtij Statuti.
7. Asociacioni do të kryejë detyra të tjera siç mund të autorizohet nga autoritetet qendrore.

Neni 18 [ushtrimi i autorizimeve të posaçme]

1. Asociacioni do të themelojë një trup të përbashkët administrativ për t'i kryer detyrat specifike të përvijuara në Nenin 17.
2. Bordi i Asociacionit e mbikëqyr dhe e menaxhon trupin e përbashkët administrativ.
3. Trupi i përbashkët administrativ do ta kryejë punën profesionale dhe administrative në emër dhe në interes të komunave pjesëmarrëse. Ky ushtrim i përbashkët në asnjë mënyrë nuk i minon apo zëvendëson statusin dhe të drejtat e komunave anëtare. Komunitat anëtare veç e veç e kanë të drejtën për të mos marrë pjesë në këtë ushtrim të përbashkët ose, në çfarëdo kohe që zgjedhin, të tërhiqen prej tij. Komunitat anëtare veç e veç gjithashtu e kanë të drejtën për të zgjedhur se në cilat fusha duan të marrin pjesë dhe në cilat fusha nuk duan të marrin pjesë. Këto vendime nuk do ta prekin statusin e tyre të anëtarësisë.

4. Trupi i përbashkët administrativ do të ketë katër departamente:

- a. Departamenti për Zhvillim Ekonomik.
- b. Departamenti për Arsim.
- c. Departamenti për Shërbime të Kujdesit Shëndetësor.
- d. Departamenti për Planifikim Urban dhe Rural.

5. Drejtorët e këtyre departamenteve përzgjidhen në mesin e anëtarëve të Bordit të Asociacionit.

6. Pas një propozimi të hollësishëm nga Bordi i Asociacionit, Kuvendi i Asociacionit duhet të saktësojë se cilat komuna anëtare do të marrin pjesë në këtë ushtrim të përbashkët, strukturën organizative, pozicionet e punës që kërkohen për ekzekutimin e këtij ushtrimi të përbashkët, procedurat për zgjidhjen e konflikteve të mundshme në mesin e komunave anëtare, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe të kontrollit, buxhetin, dhe financimin e këtij ushtrimi të përbashkët. Vendimi për të marrë pjesë në trupin e përbashkët administrativ duhet të konfirmohet ndaras nga Kuvendet Komunale të komunave anëtare që duan të bashkohen në këtë ushtrim të përbashkët.

7. Komunitetet pjesëmarrëse caktojnë shërbyes civilë komunalë për të punuar në trupin e përbashkët administrativ. Për ushtrimin e përbashkët, Asociacioni mund të rekrutojë personel shtesë.

8. Për t'i ushtruar këto autorizime të posaçme, Bordi i Asociacionit do t'i miratojë të mëposhtmet:

- a. Rregullore të Posaçme.
- b. Vendime Zbatuese për t'i zbatuar Rregulloret e Posaçme.

9. Një Rregullore e Posaçme është ekuivalente ligjore e një nën-udhëzimi administrativ.

10. Rregulloret e Posaçme synojnë që ta rrisin zbatimin e ligjeve ekzistuese dhe udhëzimeve administrative përmes përqendrimit në nevojat specifike të komuniteteve lokale që banojnë në komunitet pjesëmarrës. Përshtatja ndaj nevojave të komuniteteve lokale do t'i përmirësojë tutje cilësinë e shërbimeve publike dhe kryerjen e detyrave administrative.

11. Hierarkia nga lart - poshtë e normave ligjore është si në vijim: Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, udhëzimet administrative të miratuara nga Ministrisë specifike që e mbulojnë fushën specifike, dhe Rregulloret e Posaçme të miratuara nga Bordi i Asociacionit.

Draftuesit e Rregulloreve të Posaçme do t'i përmbahen kësaj hierarkie të normave ligjore. Draftuesit gjithashtu duhet të ofrojnë një arsyetim të hollësishëm për secilën Rregullore të Posaçme në kontekstin e nevojave specifike të komunitetit lokal dhe ndikimin e pritur ndaj këtyre nevojave të komunitetit lokal.

12. Rregulloret e Posaçme dhe Vendimet Zbatuese janë të zbatueshme vetëm në territorin e komunave që e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në trupin e përbashkët administrativ dhe vetëm gjatë kohës së pjesëmarrjes.

13. Rregulloret e Posaçme dhe Vendimet Zbatuese janë subjekt i rishikimit administrativ nga Zyra e Kryeministrit.

14. Me anë të Neneve 27 dhe 36 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, pas një marrëveshjeje specifike me autoritetet qendrore kompetente, trupi i përbashkët administrativ mundet edhe të veprojë në kapacitetin e një dege të përbashkët lokale për ministri specifike dhe agjenci ekzekutive që i mbulojnë fushat e përvijuara në Nenin 17 të këtij Statuti. Pas konsultimit me Asociacionin, Kryeministri mund të lëshojë udhëzime specifike që e përvijojnë ekzekutimin e këtij ushtrimi të përbashkët.

15. Asociacioni mund të ekzekutojë detyra të tjera të autorizuara nga Qeveria ose të ngarkuara nga Kuvendi i Kosovës.

Neni 19 [Menaxhimi i institucioneve të arsimit dhe të kujdesit shëndetësor të themeluara e të financuara nga Republika e Serbisë]

1. Deri në normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, Asociacioni është i autorizuar që t'i menaxhojë plotësisht institucionet ekzistuese të arsimit dhe të kujdesit shëndetësor të themeluara e të financuara nga Republika e Serbisë me anë të hapave të mëposhtëm:

a. Në frymën e Nenit 13 të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, "Rrjeti Serb i Arsimit" dhe "Rrjeti Serb i Kujdesit Shëndetësor" do të themelohen si ofrues të pavarur të arsimit dhe të kujdesit shëndetësor, duke e theksuar Republikën e Serbisë si themeluese dhe kontributdhënëse financiare, si dhe zyrat kryesore të këtyre ofruesve të vendosura në Republikën e Serbisë.

b. Në Kosovë, këta ofrues do ta kenë statusin e ofruesve të huaj të arsimit privat dhe të kujdesit shëndetësor privat. Qeveria e Kosovës do t'i pajisë këta ofrues me licensë operuese të përkohshme 5-vjeçare.

c. Çështjet e lidhura me kurikulën janë të rregulluara në dispozitat kalimtare të këtij Statuti.

d. Pas licensimit, Asociacioni mund ta menaxhojë plotësisht funksionimin e këtyre ofruesve të arsimit dhe të kujdesit shëndetësor. Republika e Serbisë do ta kompensojë në mënyrë të përshtatshme Asociacionin për këto shërbime.

e. Këta ofrues do të jenë të liruar nga dogana dhe nga të gjitha detyrimet e tjera për aq gjatë sa ofrojnë shërbime pa pagesë.

f. Në territorin e komunave anëtare, këta ofrues mund t'i shfrytëzojnë objektet ekzistuese publike dhe objektet publike që do të ndërtohen në të ardhmen (shkolla dhe qendra të kujdesit shëndetësor).

g. Operimi i këtyre rrjeteve në asnjë mënyrë nuk duhet ta kufizojë ose pengojë funksionimin e sistemit ekzistues të Kosovës të shkollave publike dhe sistemin e kujdesit shëndetësor publik të Kosovës.

h. Këto rrjete gjithashtu do të autorizohen për t'i ofruar shërbimet e tyre në territoret e komunave të tjera jo-anëtare. Megjithatë, për t'i shfrytëzuar objektet publike (shkollat dhe qendrat e kujdesit shëndetësor), këta ofrues duhet të sigurojnë leje nga autoritetet komunale përkatëse.

i. "Rrjeti Serb i Arsimit" do ta ketë të drejtën për të lëshuar diploma të dyfishta. Dizajni i diplomës (diplomës së Kosovës) të dhënë nga "Rrjeti Serb i Arsimit", me anë të ligjeve të zbatueshme, do të rregullohet me një marrëveshje të ndarë mes ofruesit dhe autoriteteve kompetente. Instituti themelues në Republikën e Serbisë do të lëshojë një diplomë dublikatë (diploma serbe). Vendi i lëshimit të diplomës dublikatë është qyteti (në Republikën e Serbisë) ku ndodhen zyrat kryesore. Qeveria e Kosovës do ta trajtojë diplomën dublikatë si diplomë të huaj të vlefshme.

Neni 20 [ndërmarrjet e përbashkëta publike dhe partneritetet publiko-private]

1. Për të kryer shërbime publike lokale në emër të komunave anëtare, Asociacioni mund të themelojë ndërmarrje të përbashkëta publike në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga Ligji për Ndërmarrje Publike. Kuvendi i Asociacionit duhet të nxjerrë në pah se cilat komuna anëtare marrin pjesë në këtë ushtrim të përbashkët. Komunitat pjesëmarrëse do të hyjnë në listë si bashkëthemeluese dhe bashkëpronare. Komunitat pjesëmarrëse kanë në pronësi numër të barabartë të aksioneve. Aksionet në pronësi të Asociacionit nuk mund ta tejkalojnë sasinë prej 50 për qind.

2. Në emër të komunave pjesëmarrëse që duan të marrin pjesë në një ushtrim të përbashkët, Asociacioni mund të hyjë në forma institucionale ose kontraktuese të partneritetit publiko-

privat në pajtim me kushtet dhe procedurat e përvijuara në legjislacionin përkatës për partneritete publiko-private.

Neni 21 [mbështetja e personave të kthyer]

1. Asociacioni do ta mbështetë të drejtën e të gjithë njerëzve, pavarësisht nga sfondi i tyre, që të kthehen në vendin e tyre të banimit para vitit 1999.
2. Asociacioni do ta themelojë "Departamentin për Punë të të Kthyerve" për t'i bashkërenduar dhe organizuar punët e përditshme që lidhen me mbështetjen e personave të kthyer.
3. Asociacioni do të angazhohet në përmirësimin e kushteve lokale të jetesës të të kthyerve dhe do të miratojë masa të përshtatshme në përputhje me rrethanat. Për këtë qëllim, në territorin e komunave anëtare të tij, Asociacioni mund të mbikëqyrë projekte në bashkëpunim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete. Të ofrojë asistencë të drejtpërdrejtë për të kthyerit, të grumbullojë mbështetje financiare e mbështetje tjetër për projekte të infrastrukturës, dhe t'i propozojë projekte dhe plane veprimi Qeverisë dhe komunave pjesëmarrëse.
4. Asociacioni do t'i promovojë, mbështetë dhe do të marrë pjesë në përpjekje dhe aktivitete për ndërtimin e besimit.

Neni 22 [aktivitetet hulumtuese dhe zhvillimore]

1. Asociacioni do të kryejë, bashkërendojë, dhe lehtësojë aktivitete hulumtuese e zhvillimore.
2. Asociacioni mund të themelojë një ose më shumë institucione të përbashkëta publike për të kryer, bashkërenduar dhe lehtësuar aktivitete hulumtuese e zhvillimore. Komunitat pjesëmarrëse do të hyjnë në listë si bashkëthemeluese.
3. Komunitat anëtare veç e veç janë të lira për të mos u bashkuar në këtë ushtrim të përbashkët. Ky vendim nuk e prek statusin e tyre të anëtarësisë.
4. Pas konsultimeve me komunitat pjesëmarrëse, Kuvendi i Asociacionit vendos që t'i themelojë këto institucione të përbashkëta publike. Ky vendim duhet të konfirmohet ndaras nga Kuvendet Komunale të komunave anëtare që duan të marrin pjesë në këtë ushtrim të përbashkët. Kuvendi i Asociacionit duhet të saktësojë se cilat komuna janë të interesuara që të veprojnë si bashkëthemeluese, emrin dhe selinë e institucionit, fushëveprimin e aktiviteteve të institucionit të tillë, burimet e përhershme të financimit, mënyrën dhe kushtet për garantimin e mjeteve për punën e institucionit, të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta të institucionit dhe themeluesit, kohëzgjatjen e operimit të institucionit, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e institucionit në marrëdhëniet ligjore me palët e treta, përgjegjësinë e Asociacionit dhe të komunave bashkëthemeluese, kur bëhet fjalë për borxhet e institucionit, organizimin e institucionit dhe

procedurat shoqëruese, mbikëqyrjen dhe aspekte të tjera thelbësore për funksionalizimin dhe operimin e institucionit të përbashkët në përputhje me ligjet e zbatueshme.

III - MARRËDHËNIET ME AUTORITETET QENDRORE

Neni 23 [veçoritë kyçe]

1. Asociacioni do të angazhohet me autoritetet qendrore të Kosovës duke u mbështetur në bashkëpunimin e përbashkët dhe në ndarjen e të dhënave në frymën e promovimit të demokracisë dhe multietnicitetit dhe në vijë me sistemin ligjor të Kosovës.
2. Në çështje të interesit kolektiv, Asociacioni i përfaqëson anëtarët e vet.
3. Asociacioni do t'i promovojë interesat e komunave pjesëmarrëse, komuniteteve dhe banorëve të komunave pjesëmarrëse të tij në mirëbesim dhe në frymën e multietnicitetit gjithëpërfshirës.
4. Asociacioni/Bashkësia do ta ketë të drejtën që të ketë qasje në të dhëna nga autoritetet qendrore sipas ligjeve të zbatueshme.

Neni 24 [kanali i drejtpërdrejtë i komunikimit - detyrimi për t'u konsultuar]

1. Asociacioni mund të nominojë përfaqësues në trupa dhe institucione kompetente të autoriteteve qendrore, përfshirë Këshillin Konsultativ për Komunitete.
2. Në çfarëdo kohe, Asociacioni mund të kërkojë nga Zyra e Kryeministrit dhe autoritetet e tjera përkatëse përfshirje të menjëhershme në procesin e konsultimit para të gjitha vendimeve dhe veprimeve që mund të ndikojnë në objektivat e Asociacionit. Zyra e Kryeministrit dhe autoritetet e tjera përkatëse duhet t'i ofrojnë Asociacionit një mundësi të vërtetë që të dëgjohet dhe t'i diskutojë çështjet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Dështimi për ta shfrytëzuar këtë mundësi nuk i parandalon në asnjë mënyrë Zyrën e Kryeministrit dhe autoritetet përkatëse nga vazhdimi në çështje. Vëzhgues nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës dhe bërthama diplomatike që është e pranishme në Kosovë mund të ftohen (nga cilado palë) për t'i vëzhguar këto diskutime.
3. Qeveria do ta ftojë Asociacionin që ta paraqesë opinionin e tij (me shkrim) gjatë procesit konsultativ për të draftuar legjislacion të ri ose për ta amendamentuar legjislacionin ekzistues për qeverisje lokale dhe të drejta të komunitetit. Asociacioni është i lirë (dhe i inkurajuar) që ta paraqesë opinionin e vet (me shkrim) për çfarëdo drafti tjetër të legjislacionit që mbulon çfarëdo fushe që Asociacioni e konsideron se është me interes apo shqetësim.
4. Asociacioni mund të ngrejë shqetësime me autoritete qendrore në lidhje me diversitetin etnik të Policisë së Kosovës që i mbulon komunat anëtare, cilësinë e mbajtjes së rendit nga

policia në komunitet, përfaqësimin proporcional etnik në institucione, dhe çfarëdo çështje tjetër me interes për objektivat e Asociacionit. Autoritetet përkatëse duhet t'i ofrojë Asociacionit një mundësi të vërtetë që të jetë i dëgjuar dhe t'i diskutojë çështjet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Vëzhgues nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës dhe bërthama diplomatike që është e pranishme në Kosovë mund të ftohen (nga cilado palë) për t'i vëzhguar këto diskutime.

Neni 25 [Policia e Kosovës]

1. Komandanti i Komandës Rajonale të Policisë së Kosovës që i mbulon katër komunat veriore (Severna Mitrovica/Mitrovicë e Veriut, Zvečan/Zveçan, Leposavic/Leposaviq dhe Zubin Potok) përzgjidhet nga një listë e nominimeve të paraqitur nga Asociacioni.

2. Kryetarët e këtyre komunave e hartojnë listën e nominimeve.

Neni 26 [nisma legislative]

1. Me anë të Nenit 79 të Kushtetutës, Asociacioni nuk është palë e autorizuar për të propozuar drejtpërdrejt legjislacion të ri. Megjithatë, në mirëbesim, Zyra e Kryeministrit do të punojë me Asociacionin për t'i akomoduar interesat e nismave të tilla.

2. Asociacioni mund të paraqesë te Kryeministri propozime legislative përkatëse me vetëqeverisjen lokale dhe propozime legislative përkatëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komunitetit serb të Kosovës. Në mirëbesim, pa paragjykim ndaj përmbajtjes, në emër të Asociacionit, Zyra e Kryeministrit do t'ia përcjellë këto propozime Kuvendit të Kosovës për shqyrtim të mëtejshëm. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se Qeveria është sponsorja zyrtare e legjislacionit të propozuar. Opinioni ligjor dhe administrativ i Zyrës së Kryeministrit do t'u bashkëngjitet propozimeve si dërgesë e ndarë.

Neni 27 [referimi në gjykatë]

1. Asociacioni do ta ketë të drejtën për të nisur ose për të marrë pjesë në procedura para Gjykatave kompetente kundër çfarëdo akti ose vendimi nga çfarëdo institucioni që e prek ushtrimin nga Asociacioni të kompetencave të tij siç janë përvijuar në këtë Statut.

2. Duke vepruar në emër të anëtarësisë së tij, përmes një veprimi ligjor kolektiv të të gjitha komunave anëtare, Asociacioni mund të bëjë një referim në Gjykatën Kushtetuese kundër çfarëdo akti ose vendimi nga çfarëdo institucioni që besohet se i minon ose i prek të drejtat dhe autorizimet e Asociacionit për të vepruar si trup i përbashkët ndërkomunal, siç është përvijuar në këtë Statut.

3. Asociacioni mund t'i paraqesë Kryeministrit një referim të rastit kushtetues kundër çfarëdo akti ose vendimi të çfarëdo institucioni që besohet se e shkel Kapitullin III të Kushtetutës. Në mirëbesim, Zyra e Kryeministrit do t'ia përcjellë këto referime Gjykatës Kushtetuese në emër të Asociacionit.

IV - STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 28 [trupat e Asociacionit]

1. Trupat e Asociacionit do t'i promovojnë bashkekzistencën dhe paqen mes qytetarëve të komunave anëtare të tyre dhe do ta inkurajojnë ndërtimin e përshtatshëm të kushteve për t'u mundësuar të gjitha komuniteteve që t'i shprehin, t'i ruajnë, dhe t'i zhvillojnë identitetet e tyre kombëtare, etnike, kulturore, fetare e gjuhësore.

2. Asociacioni/Bashkësia do t'i ketë trupat e mëposhtëm:

Kuvendi i Asociacionit.

Presidenti i Asociacionit.

Nënpresidenti i Asociacionit.

Këshilli i Asociacionit.

Bordi i Asociacionit.

Zyra e Apelit dhe e Ankesave e Asociacionit/Bashkësisë.

Neni 29 [Kuvendi i Asociacionit]

1. Kuvendi i Asociacionit është trupi më i lartë i Asociacionit.

2. Kuvendi i Asociacionit do të:

a. Miratojë dhe amendamentojë Statutin.

b. Miratojë Rregullore, Rregullore të Posaçme, Rregulla të Procedurës, vendime, deklarata, deklarime.

c. Emërojë dhe shkarkojë Presidentin, Nënpresidentët e Komunitetit, Kryetarin dhe Nënkryetarët e Kuvendit të Asociacionit, Bordin e Asociacionit, ose anëtarë të përzgjedhur të Bordit, dhe çfarëdo zyrtari tjetër që është drejtpërdrejt përgjegjës ndaj Kuvendit të Asociacionit, me anë të procedurave të përvijuara në këtë Statut.

d. Shqyrtojë dhe miratojë buxhetin e Asociacionit.

- e. Diskutojë, shqyrtojë dhe përcaktojë prioritete politikash.
 - f. Shqyrtojë dhe miratojë marrëveshje bashkëpunimi me palë të treta.
 - g. Rregullojë të gjitha punët që i përkasin funksionimit të brendshëm të Asociacionit.
3. Vendimet merren me shumicë votash, me kusht që shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (50 për qind + 1) të jenë të regjistruar si të pranishëm dhe që kanë votuar.
 4. Kryetari i Kuvendit të Asociacionit, dhe së paku dy Nënkryetarë, zgjidhen në mesin e anëtarëve të Kuvendit të Asociacionit përmes shumicës së votave të të gjithë anëtarëve.
 5. Mandati i anëtarëve të Kuvendit është katër vjet. Megjithatë, në çfarëdo kohe, secila komunë pjesëmarrëse e ka të drejtën për t'i zëvendësuar përfaqësuesit e saj, përmes votimit me shumicë në Kuvendin Komunal përkatës.

Neni 30 [Bordi i Asociacionit]

1. Bordi i Asociacionit është trupi ekzekutiv i Asociacionit.
2. Bordi e propozon buxhetin vjetor.
3. Bordi është përgjegjës për ekzekutimin e buxhetit dhe miratimin e pagesave, ai i menaxhon asetet e Asociacionit, dhe punë të tjera të përditshme të Asociacionit.
4. Bordi i Asociacionit i përgatit raportet e performancës.
5. Bordi i Asociacionit i raporton drejtpërdrejt Kuvendit të Asociacionit.
6. Bordi i Asociacionit ka shtatë (7) anëtarë.
7. Përbërja e Bordit do ta pasqyrojë diversitetin etnik të komunave pjesëmarrëse.
8. Kryetari, dhe nënkryetarët, e Bordit të Asociacionit zgjidhen mes vete.
9. Presidenti i Asociacionit, kryetari i Kuvendit të Asociacionit, dhe cilido anëtar tjetër i Kuvendit të Asociacionit, mund të nominojë kandidatë për të shërbyer si anëtarë të Bordit. Këta kandidatë përzgjidhen nga mesi i kryetarëve dhe banorëve të komunave pjesëmarrëse.
10. Anëtarët e Bordit zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Asociacionit.
11. Mandati i Bordit është katër (4) vjet.

12. Anëtarët e Bordit mbështeten në punën e tyre nga kolegji me profesionale, të përbëra nga ekspertë. Bordi vendos për fushëveprimin e punës së secilit kolegji. Këto kolegji janë paraqitur më poshtë:

- a. Kolegji për Zhvillim Ekonomik,
- b. Kolegji për Arsim,
- c. Kolegji për Kujdes Shëndetësor,
- d. Kolegji për Planifikim Urban dhe Rural,
- e. Kolegji për Hulimtim dhe Zhvillim,
- f. Kolegji për të Drejta Njerëzore dhe të Komunitetit,
- g. Kolegji për Cilësi të Shërbimeve Publike,
- h. Kolegji për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 31 [Kryetari i Bordit]

1. Kryetari është Shef Ekzekutiv i Asociacionit. Ai/ajo e menaxhon dhe e bashkërendon punën e Bordit dhe e përfaqëson Bordin.
2. Ai/ajo i menaxhon burimet njerëzore të Asociacionit.
3. Ai/ajo është i/e autorizuar për të nënshkruar kontrata në emër dhe për llogarinë e Asociacionit.
4. Ai/ajo ia paraqet raportin e performancës Kuvendit të Asociacionit.
5. Kryetari mund t'ia delegojë detyrat e vet cilitdo anëtar tjetër të Bordit.

Neni 32 [Presidenti i Asociacionit]

1. Presidenti i Asociacionit e përfaqëson Asociacionin para autoriteteve qendrore dhe palëve të treta, të brendshme e të jashtme.
2. Presidenti i Asociacionit zgjidhet nga Kuvendi i Asociacionit, nga mesi i anëtarëve të asambleve të komunave pjesëmarrëse dhe kryetarët e tyre. Procedurat e zgjedhjes janë të rregulluara me Rregullat e Procedurës të Kuvendit të Asociacionit.
3. Nënpresidenti i Asociacionit do t'ia asistojë Presidentit në kryerjen e detyrave të tij/saj. Nënpresidenti zgjidhet nga Kuvendi nga mesi i anëtarëve të asambleve të komunave

pjesëmarrëse dhe kryetarët e tyre. Procedurat e zgjedhjes janë të rregulluara me Rregullat e Procedurës të Kuvendit të Asociacionit.

4. Mandatet e Presidentit dhe Nënpresidentëve janë katër (4) vjet. Megjithatë, pas secilit cikël të zgjedhjeve lokale, Kuvendi i Asociacionit mund të thërrasë mocion mosbesimi, me anë të procedurave të rregulluara në Rregullat e Procedurës.

Neni 33 [Këshilli i Asociacionit]

1. Këshilli i Asociacionit është trup këshillues që ofron udhëzime për punën e Asociacionit.

2. Këshilli i Asociacionit do të ketë më së shumti tridhjetë (30) anëtarë. Anëtarësia në këshill do ta pasqyrojë diversitetin etnik të komunave pjesëmarrëse.

3. Në saje të pozitës së tyre, të gjithë kryetarët e komunave pjesëmarrëse janë anëtarë të Këshillit.

4. Anëtarët e tjerë zgjidhen nga mesi i banorëve të komunave pjesëmarrëse.

5. Rregullat dhe procedurat për t'i zgjedhur anëtarët e tjerë të Këshillit do të rregullohen përmes një Rregulloreje të miratuar nga Kuvendi i Asociacionit.

Neni 34 [Administrimi i Asociacionit]

1. Asociacioni do të ketë një administratë, të udhëhequr nga një Shef i Administratës i caktuar nga Bordi dhe që i raporton Bordit.

2. Administrata e mbështet punën e Asociacionit, në veçanti Bordin dhe Presidentin.

3. Stafi i administratës përbëhet nga qytetarë të paanshëm, profesionistë dhe të përgjegjshëm të Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre komunal. Stafi i administratës i pasqyron multietnicitetin dhe standardet e barazisë të rrënjësura në ligjet e zbatueshme. Stafi i administratës punësohet nga Bordi duke u mbështetur në merita dhe pas kalimit të procedurave të përzgjedhjes, të draftuara e të miratuara nga Kuvendi i Asociacionit.

4. Stafi i administratës do të përfitojë nga një status formal i punësimit me Asociacionin dhe do t'i gëzojë të drejtat dhe mbrojtjen që u ofrohen punëtorëve përmes Ligjit të Punës.

Neni 35 [Zyra e Apelit dhe e Ankesave e Asociacionit]

1. Zyra e Apelit dhe e Ankesave do të jetë e autorizuar për të pranuar dhe diskutuar apele dhe ankesa nga autoritetet komunale (kryetari dhe kuvendi komunal) të komunave pjesëmarrëse ose grupeve qytetare, entiteteve tregtare, ose sindikatave profesionale nga komunat pjesëmarrëse.

2. Ankesat dhe apelet që mund të dorëzohen në këtë Zyrë janë ato që u përkasin shkeljeve të pretenduara nga Asociacioni kundër të drejtave dhe interesave të komunave pjesëmarrëse të tij, banorëve të tyre, entiteteve tregtare, ose shoqatave profesionale.

3. Zyra gjithashtu do ta ketë mandatin për të pranuar dhe diskutuar mocione dhe peticione nga aktorë shoqërorë nga komunat pjesëmarrëse në lidhje me përmbushjen e objektivave dhe funksionimin e trupave të Asociacionit.

4. Vendimet e kësaj Zyre në lidhje me ankesat, apelet dhe peticionet e dorëzuara në të do të jenë të zbatueshme për trupat përkatës të Asociacionit.

5. Vendimet e kësaj Zyre mund të apelojnë në Gjykata.

6. Struktura dhe organizimi i brendshëm i kësaj Zyre janë të rregulluar nga Kuvendi i Asociacionit.

V - BUXHETI DHE FINANCIMI

Neni 36 [Buxheti]

1. Asociacioni do ta ketë buxhetin e vet, i cili do të administrohet në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies, dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

2. Asociacioni do të ketë një buxhet të integruar vjetor të propozuar nga Bordi i tij dhe të miratuar nga Kuvendi i tij. Buxheti vjetor i tij do të jetë proporcional, i përcaktuar dhe i përshtatshëm për objektivat e Asociacionit dhe funksionimin e trupave të tij siç përcaktohet nga ky Statut. Zyra e Kryeministrit dhe Auditori i Përgjithshëm do ta kryejnë rishikimin e draft-buxhetit brenda 15 ditëve nga dita e pranimit. Nëse vlerësohet se ai është në përputhje me rregullat, autoritete qendrore do ta njoftojnë Kuvendin e Asociacionit, i cili pastaj do ta miratojë buxhetin përmes procedurave të tij të përcaktuara. Nëse vlerësohet se një pjesë e draft-buxhetit nuk është në përputhje me rregullat, Zyra e Kryeministrit dhe Auditori i Përgjithshëm nuk do ta mbajnë pezull tërë buxhetin e integruar. Në raste të tilla, Kuvendit të Asociacionit do t'i jepen rekomandime për amendamentimin ose eliminimin e dispozitave të kontestuara të buxhetit. Nëse Kuvendi i Asociacionit nuk pajtohet me rekomandimet e autoriteteve qendrore, ai duhet t'i njoftojë ato brenda 10 ditëve të punës. Në raste të tilla, Zyra e Kryeministrit do ta referojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, vendimi i së cilës do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për të gjitha palët.

4. Nën dispozitat e renditura më lart, Asociacioni do të ketë autonomi të plotë në menaxhimin dhe leximin e buxhetit të tij të integruar.

Neni 37 [mënyrat e financimit]

1. Asociacioni do të finanohet nga:

- a. Kontributet nga anëtarët e vet.
- b. Të ardhurat dhe të hyrat nga shërbimet e ofruara nga Asociacioni/Bashkësia, kompanitë e tij ose të tërhequra nga asetet e tij të luajtshme ose të paluajtshme.
- c. Transferet nga autoritetet qendrore.
- d. Kontributet, grantet, donacionet, si dhe përkrahja financiare nga asociacione e organizata të tjera, të brendshme e ndërkombëtare, përfshirë Republikën e Serbisë.

2. Cilido financim që Asociacionit mund t'i caktohet që ta pranojë përtej buxhetit të tij të integruar vjetor, do të jetë për shpenzime në vijë me këtë Statut dhe do të kërkojë miratim specifik nga Zyra e Kryeministrit.

Neni 38 [mbikëqyrja]

1. Shpenzimet e Asociacionit do të jenë subjekt i auditimeve nga autoritetet kompetente, përfshirë nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës.
2. Asociacioni do t'i ofrojë raporte vjetore Zyrës së Kryeministrit për pranimin dhe menaxhimin e fondeve të veta.
3. Asociacioni nuk do të shkelë në kompetencat ekzekutive të komunave pjesëmarrëse të garantuara me Nenin 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

VI - DISPOZITAT E PËRZIERA

Neni 39 [Fushëveprimi i Zyrës së Kryeministrit]

1. Fushëveprimi i Zyrës së Kryeministrit është i kufizuar në shqyrtimin administrativ (siç theksohet në pikën 14 të Nenit 18 të këtij Statuti) dhe në mbikëqyrjen e cilësisë së performancës me anë të kodit të sjelljes në shërbimin publik, dhe në vlera të tjera, siç përcaktohen me anë të ligjeve të zbatueshme.
2. Për ta siguruar pajtueshmërinë me Kushtetutën, ky Statut dhe ligjet e zbatueshme përkatëse, të gjitha Rregulloret e Posaçme dhe Vendimet Zbatuese do të kalojnë nëpër një shqyrtim administrativ nga Zyra e Kryeministrit. Procesi i shqyrtimit administrativ ndodh brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike pas dorëzimit të të dhënave nga Asociacioni. Vetëm pas një shqyrtimi pozitiv, këto vendime mund të zbatohen.

3. Nëse Asociacioni e kundërshton rezultatin e shqyrtimit administrativ, Zyra e Kryeministrit do të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese një opinion. Referimi ndodh jo më vonë se tri (3) ditë pune pasi Asociacioni ta njoftojë (me shkrim) Zyrën e Kryeministrit për mospajtimin e tij me rezultatin. Opinions i Gjykatës është përfundimtar.

4. Për detyrat e deleguara, të përvijuara në nenet 17 dhe 18 të këtij Statuti, Kryeministri do të caktojë një njësi të përbashkët përgjegjëse për ta vëzhguar cilësinë e treguesve të performancës. Njësia përgjegjëse do të përbëhet nga një numër i barabartë i anëtarëve që i përfaqësojnë Asociacionin dhe Zyrën e Kryeministrit. Njësia përgjegjëse do të themelojë një sistem të matjes së treguesve matës të cilësisë së performancës për ta vëzhguar në mënyrë efikase cilësinë e performancës së detyrave të deleguara.

5. Kryeministri do t'i miratojë ndaras këta tregues të performancës pas konsultimit me Bordin e Asociacionit. Këta tregues nuk duhet ta pengojnë në asnjë mënyrë pavarësinë funksionale të Asociacionit.

6. Njësia përgjegjëse përgatit dhe paraqet të paktën një raport vjetor te Kryeministri.

7. Kjo njësi përgjegjëse gjithashtu do ta vëzhgojë zbatimin e Nenit 20 të këtij Statuti në lidhje me menaxhimin e institucioneve të arsimit dhe të kujdesit shëndetësor të themeluara dhe të financuara nga Republika e Serbisë.

8. Për këtë qëllim, njësia përgjegjëse përgatit dhe paraqet të paktën një raport vjetor te Kryeministri.

Neni 40 [punësimi dhe statusi i stafit]

1. Asociacioni do ta caktojë ose punësojë stafin e vet me anë të standardeve dhe procedurave të përvijuara në ligjet e zbatueshme.

2. Me anë të Ligjit për Zyrtarët Publikë, stafi administrativ që kryen detyra specifike të përvijuara në Nenet 17 dhe 18 do ta ketë statusin e shërbyesve publikë.

3. Anëtarët e Bordit të Asociacionit do ta kenë statusin e shërbyesve publikë.

Neni 41 [zyrat përfaqësuese]

1. Për përfaqësim, promovim e arritje më të mirë të interesave të komunave anëtare, Asociacioni mund të themelojë zyra përfaqësuese në komuna të tjera jashtë anëtarësisë së tij.

2. Këto zyra mund të themelohen edhe jashtë vendit.

3. Financimi i këtyre zyrave nuk duhet t'i prekë aktivitetet e Asociacionit.

Neni 42 [shërbimi i ndihmës juridike]

1. Asociacioni mund të themelojë një zyrë për ndihmë juridike për të ofruar asistencë juridike falas.

2. Asistenca juridike do t'u ofrohet të gjithë personave që nuk mund ta përballojnë asistencën juridike profesionale pa e komprometuar ekzistencën e vet, pavarësisht nga sfondi i tyre apo vendi i banimit.

Neni 43 [Buletini Zyrtar]

1. Buletini Zyrtar është një burim "online" që menaxhohet nga Asociacioni dhe ku të gjitha vendimet e trupave të Asociacionit do të publikohen.

2. Rregulloret e Posaçme dhe Vendimet Zbatuese publikohen vetëm pas një shqyrtimi administrativ pozitiv, me anë të Nenit 39 të këtij Statuti.

3. Të gjitha publikimet publikohen në tri gjuhë: serbisht, shqip, dhe anglisht.

VI - DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 44

1. Brenda pesë vjetëve, kurikulat e "Rrjetit Serb të Arsimit" duhet të harmonizohen me Kornizën Kurikulare të Kosovës, përpos nëse rregullohet ndryshe përmes një marrëveshjeje dypalëshe mes Kosovës dhe Serbisë. Pas harmonizimit të kurikulave, "Rrjeti Serb i Arsimit" do të pajiset me një licensë standarde të operimit.

2. Pas një marrëveshjeje dypalëshe mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për rregullimin e bashkëpunimit dhe asistencës reciproke në fushën e kujdesit shëndetësor, "Rrjeti Serb i Kujdesit Shëndetësor" do të pajiset me një licensë standarde të operimit.

3. Në pritje të një normalizimi të plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, licensave të përkohshme mund t'u zgjatet afati përmes një vendimi të Qeverisë.

4. Në pritje të një normalizimi të plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, Asociacioni mund të autorizohet për t'i menaxhuar përkohësisht shërbimet e tjera që ofrohen nga institucionet e themeluara dhe të financuara nga Republika e Serbisë pas një marrëveshjeje të ndarë mes Kosovës dhe Serbisë.

VII - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 45

1. Brenda një viti pas miratimit të këtij Statuti, Komisioni i Përbashkët Vëzhgues do ta shqyrtojë zbatimin e tij përmes mbikëqyrjes së zbatimit të "Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë".

www.gazetaexpress.com